



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN

Nr. 3630/1 Prot.

Tiranë, më 09.07.2024

Lënda: Kthim përgjigjeje shkresës Suaj Nr. 2584 Prot., datë 28.06.2024, “Ftesë për bashkëpunim”.

Z. FATMIR XHAFAJ
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
KUVENDI

I nderuar Z. Xhafaj,

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe si Ministri përgjegjës për avancimin e parimeve të qeverisjes së mirë, mbështet plotësisht misionin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “*Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian*”.

Në përgjigje të gatishmërisë sonë për bashkëpunim me Komisionin e Posaçëm, si dhe në vijim të kërkesës suaj për vënien në dispozicion të materialeve të dedikuara të hartuara në 5 vitet e fundit që lidhen me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së këtij Komisioni, Ju përcjellim një paketë materialesh analitike që adresojnë performancën e institucioneve shqiptare në luftën kundër korrupsionit, konsolidimin e mirëqeverisjes dhe avancimin e shtetit të së drejtës për këtë periudhë reference.

Materialet në përmbajtje të kësaj pakete përmbajnë vlerësime të ecures së reformave në vend nga partnerët kyçë ndërkombëtarë dhe misionet e rëndësishme dhe të dedikuara vlerësuese për Shqipërinë, si dhe vlerësime më të gjera rajonale e globale, ku performanca e autoriteteve shqiptare vlerësohet krahasimisht me vendet e tjera. Lista e plotë e materialeve reflektohet në Aneksin bashkëlidhur kësaj shkrese.

Njëherësh, Ju komunikojmë se nga zyra e Ministrit të Shtetit, si dhe nga Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion - si dy strukturat teknike me kompetenca të lidhura ngushtësisht me punën e Komisionit të Posaçëm Parlamentar - pikat e kontaktit janë të mëposhtmet:

1. Znj. Silvana Rusi, Këshilltar i Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin;
2. Znj. Marcela Kereku, Drejtor i Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore, Departamenti i Administratës Publike, dhe
3. Znj. Rovena Prega, Drejtor i Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion.

Në vijim, ne mbetemi të përkushtuar për të përkrahur dhe asistuar punën e Komisionit me të gjithë informacionin e mëtejshëm të nevojshëm mbi ecurinë e reformave në fushat objekt i veprimtarisë së Komisionit, si dhe angazhimeve të ndërmarra në kuadër të plotësimit të detyrimeve të Shqipërisë përgjatë negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

ADEA PIRDENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN

*Listë e hartuar për qëllime të mbështetjes së punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar
“Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për
Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”.*

Raporte & Analiza mbi Luftën kundër Korrupsionit

1. Përmbledhje e gjetjeve ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit për vitin 2023;
2. Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Shqipërinë 2023;
3. Komisioni Evropian, Raporti i Shqyrtimit Analitik për Grupkapitujt I “Themeloret”, (publikuar më korrik 2023);
4. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Raportim për Këshillin Kombëtar të Integritimit Evropian “Mbi ecurinë në Luftën kundër Korrupsionit dhe Reformën në Administratën Publike”, Maj 2024;
5. OECD, Raporti “Konkurrueshmëria në Ballkanin Perëndimor”, 2024;
6. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport Monitorimi 2022-2023 “Sinjalizimi në 9 Bashki të vendit”, 2024;
7. Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion & IDRA “Analiza dhe vlerësimi i riskut për Korrupsion për institucionet pjesë e veprimtarisë së Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit”, 2023;
8. Qëndresa Qytetare, “Perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin në Shqipëri”, 2023;
9. Albanian Institute of Science, Dokument Politikash “Kontrolli i integritetit të kontraktorëve publikë: Praktika e BE-së dhe kontraktimi në kontekstin shqiptar”, 2023;
10. IDRA & CeSID, “Studim për parandalimin dhe perceptimin e korrupsionit në arsimin e lartë në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi”, 2023;
11. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Anketa e Barometrit të Sigurisë së Ballkanit Perëndimor në Shqipëri, “Perceptimi publik ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe çështjeve të korrupsionit në Shqipëri”, 2023;
12. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Anketa e Barometrit të Sigurisë së Ballkanit Perëndimor në Shqipëri, Perceptimi ndaj sigurisë publike, kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë Në Shqipëri”, 2022;

13. Albanian Institute of Science, Policy Paper “Public Procurement: Albania through the lens of European Integration”, 2022;
14. World Economic Forum, Raporti “Risqet globale 2022”;
15. UNODC, “Udhërrëfyese kundër Korrupsionit dhe Financave të paligjshme në Ballkanin Perëndimor”, 2021;
16. GRECO, Raundi V i Vlerësimit, Raporti i Përputhshmërisë “Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funksione të larta ekzekutive) dhe agjencitë ligjzbatuese”, 2023;
17. GRECO, Raundi V i Vlerësimit, Raport Vlerësimi “Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funksione të larta ekzekutive) dhe agjencitë ligjzbatuese”, 2020;
18. GRECO, Raundi IV i Vlerësimit, Shtojcë e Raportit të Përputhshmërisë “Parandalimi i korrupsionit në lidhje me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët”, 2020;
19. UNCAC, Raporti i Vetëvlerësimit të Shqipërisë mbi Parandalimin, dhe Rikuperimin e Aseteve, 2018;
20. CorruptionRisk.org, Vlerësimi i Shqipërisë për Parashikimin e Riskut të Korrupsionit, Indeksin e Integritetit Publik dhe Indeksin e Transparencës 2023, aksesueshëm vetëm online në lidhjen <https://corruptionrisk.org/country/?country=ALB>;
21. Transparency International, Corruption Perception Index, 2023, aksesueshëm vetëm online në lidhjen <https://www.transparency.org/en/news/cpi-2023-eastern-europe-central-asia-autocracy-weak-justice-systems-widespread-enabling-corruption>;
22. Transparency International, Corruption Perception Index, 2022;
23. Southeast European Leadership for Development & Integrity (SELDI), “State Capture and Corruption Risks in Fiscal Transfers and Public Procurement at the Local Level in Southeast Europe”, 2023;
24. SELDI, “Public Procurement Integrity in Southeast Europe: Mechanisms, Red Flags, and State-Owned Enterprises in the Energy Sector”, 2022;
25. ACER & SELDI, Results of the Corruption Monitoring System Albania, 2021;

Raporte & Analiza mbi Qeverisjen e Mirë dhe Shtetin e së Drejtës

26. Përmbledhje e gjetjeve ndërkombëtare për Qeverisjen e Mirë 2023;
27. Përmbledhje e gjetjeve ndërkombëtare për Shtetin e së Drejtës 2023;
28. VKM Nr. 736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës”;
29. VKM Nr. 737, datë 13.12.2023 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike”;
30. Partneriteti për Qeverisje të Hapur/OGP, Plani Kombëtar i Veprimit i Shqipërisë 2023-2025;
31. Partneriteti për Qeverisje të Hapur/OGP – Mekanizmi i Pavarur i Raportimit/Independent

- Reporting Mechanisms, Vlerësimi i hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit i Shqipërisë 2023-2025;
32. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, Policy Paper “Institutional capacities as an influencing factor in the process of aligning Albanian legislation with the EU acquis”, 2023;
 33. OECD/SIGMA, Raporti i Vlerësimit për Reformën në Administratën Publike, 2021 (i cili pritet të pasohet nga Raporti i radhës në muajt në vijim brenda vitit 2024);
 34. Freedom House, Raporti “Liria në Botë/Freedom in the World”, 2023;
 35. European Network of National Human Rights Institutions, “Raporti për Gjendjen e Shtetit të së Drejtës në Shqipëri”, 2023;
 36. V-Dem Institute, “Raporti për Demokracinë 2023 ‘Kundërshtia përballë autokracisë/Defiance in the face of autocratization’”;
 37. IDRA, “Albania National Survey”, 2023;
 38. World Justice Project/WJP, “Rule of Law Index 2023”;
 39. World Justice Project/WJP, “Rule of Law Index 2022”;
 40. World Justice Project/WJP “Rule of Law Index 2021”;
 41. Departamenti i Shtetit SHBA, “Albania 2023 Human Rights Report”, <https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>;
 42. Departamenti i Shtetit SHBA, “Albania 2022 Human Rights Report”;
 43. Departamenti i Shtetit SHBA, “Albania 2021 Human Rights Report”;
 44. Bertelsmann Stiftung, Bertelsmann Transformation Index/BTI 2024, Raporti për Shqipërinë;
 45. Bertelsmann Stiftung, Bertelsmann Transformation Index/BTI 2022, Raporti për Shqipërinë;
 46. Institute for Democracy and Mediation, “Sondazhi i opinionit publik 2023: Besimi në qeverisje”.
 47. Institute for Democracy and Mediation, “Sondazhi i opinionit publik 2022: Besimi në qeverisje”;
 48. Economist Intelligence Unit: Democracy Index, 2022.